

PËRZGJEDHJA E KANDIDATËVE UPT 2017_2018

Përzgjedhja e kandidatëve, që do të aplikojnë në një program studimi, do të bëhet duke ju referuar në masën 70% notës mesatare të shkollës së mesme, sipas kriterit të notës mesatare të përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave për vitin akademik 2017-2018 (VKM 346, date 19.04.2017), sipas Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë" neni 74, pika 1, si dhe në masën 30% mesatare aritmetike të peshuara të tre lëndëve *Matematike, Fizike dhe Kimi*, në të tre vitet e shkollës së mesme sipas koeficientëve të dhëna në formulën e mëposhtme. Rezultati i vlerësimit të mësipërm do të ponderohet me koeficientin e shkollës së mesme, të përcaktuar për çdo program studimi, sipas specifikave të tyre dhe të publikuar nga UPT:

[0.7*MesVKM + 0.3(0.5*MesMatematike + 0.4*MesFizike + 0.1*MesKimi)]*Kkoef. Shkollës*1000

Ku:

Mes VKM, nota mesatare e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave për vitin akademik 2017-2018, sipas Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë" neni 74, pika 1;

Mes Matematike, nota mesatare e thjeshtë e matematikës në të gjitha vitet e shkollës së mesme, *përfshirë rezultatin në Maturën Shtetërore në provimet e detyruara dhe në provimet me zgjedhje;*

Mes Fizike, nota mesatare e thjeshtë e fizikës në të gjitha vitet e shkollës së mesme, *përfshirë rezultatin në Maturën Shtetërore të provimit me zgjedhje;*

Mes Kimi, nota mesatare e thjeshtë e kimisë në të gjitha vitet e shkollës së mesme, *përfshirë rezultatin në Maturën Shtetërore të provimit me zgjedhje;*

Kkoef. Shkollës, koeficienti i shkollës së mesme, për vitin akademik 2017-2018, sipas tabelës së koeficientëve për vitin akademik 2017-2018, bashkëlidhur.